



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË



Nr. _____ Prot

Datë ____ 02.2026

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

Date 23.02.2026

Drejtuar: Operatorit Ekonomik "G E A" SHPK, NIPT K33931040W, Adresa: Lagjja 4, Rruga Todi Vogli, Objekti nr.7

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO ☒

Tipi i kontrates: **Mallra**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Numri i procedurës **REF-75373-02-05-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti: **Furnizime dhe shërbime me ushqim per mencent (per nevoja te Qendrës Ditore të Zhvillimit)"**

Fondi limit: **1.416.390 lekë pa tvsh**

Afati: **Nga data e lidhjes se kontrates deri më 31.12.2026**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **06.02.2026**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: **Datë 09.02.2026, Nr.13**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Shoqeria " G E A " SHPK, NIPT K33931040W me vleren:

1.283.450 (nje milion e dyqind e tetedhjetë e tre mijë e katerqind e pesedhjetë) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

2. Subjekti Selviqe Abasllari Person Fizik NIPT L64704601S me vleren:

1.295.000 (nje milion e dyqind e nentedhjetë e pese mijë) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga pjesëmarrësit është s'kualifikuar, Ofertuesi i mëposhtëm:

1. Subjekti Selviqe Abasllari Person Fizik, NIPT L64704601S për arsye:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik nuk përmbush kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si më poshtë:

1. Në kundërshtim me kërkesat e Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit, pika 2 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", 1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9; operatori ekonomik nuk ka plotësuar rubrikën për deklarimin e personave në cilësinë e anëtarëve të organit administrativ, drejtuesve apo personave me kompetenca përfaqësuese/kontrolluese, duke mos shënuar të dhënat identifikuese (emër, mbiemër, numër personal). Për pasojë, Autoriteti Kontraktor është në pamundësi të verifikojë gjendjen gjyqësore të këtyre personave referuar njoftimit të përbashkët të Agjencisë të Prokurimit Publik Nr 1155 Prot dhe Ministrisë të Drejtësisë Nr 1001/1Prot datë 01.02.2019.

2. Në kundërshtim me kërkesat e Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit, pika 2 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", 2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim; kriteri 2.3.5 dhe 2.3.6 të dokumenteve të tenderit në lidhje me disponimin e automjeteve operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë automjete për kryerjen e furnizimit të ushqimeve si buke dhe fruta perime dhe automjet frigoriferik për kryerjen e furnizimit të ushqimeve vezë, qumësht dhe nënprodukte të tij si dhe mishit dhe nënprodukteve të tij. Është parashikuar që kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Operatori ekonomik ka deklaruar disponimin e automjeteve të kërkuara, por nuk ka paraqitur të dhënat konkrete identifikuese të tyre, në kundërshtim me kërkesat e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili parashikon shprehimisht: "Makinë e mjete – Po/Jo. Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete." Qëllimi i këtij përcaktimi është identifikimi i saktë i mjeteve që operatori disponon, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë ekzistencën, përshtatshmërinë dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat teknike të procedurës. Mosdeklarimi i të dhënave identifikuese të mjeteve pamundëson verifikimin e deklarimit të operatorit ekonomik; krijon paqartësi mbi disponueshmërinë reale të mjeteve; përbën mosplotësim të kërkesave të dokumenteve të tenderit. Për rrjedhojë, deklarimi konsiderohet i paplotë dhe kriteri përkatës i kualifikimit vlerësohet i papërmbushur, duke çuar në skualifikimin e operatorit ekonomik. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, Komisioni vendosi skualifikimin e operatorit ekonomik.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ofertuesin " G E A " SHPK, NIPT K33931040W, Adresa Lagjja 4, Rruga Todi Vogli, Objekti nr.7, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1.283.450 (nje milion e dyqind e tetedhjetë e tre mijë e katerqind e pesedhjetë) leke pa tvsh, **është identifikuar si ofertues i sukseshëm.**

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**